



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTERRI

Numri i lëndës: 2021:035428

Datë: 21.01.2025

Numri i dokumentit: 06732844

P.nr.226/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTERRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen juridiko-penale kundër të pandehurit L.Sh. nga fshati ..., komuna e Lipjanit, për shkak të veprës penale *Mashtrimi* nga neni 323 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.362/21 e datës 26.05.2021, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor e publik të mbajtur me datë 20.01.2025, në të cilin ishin të pranishëm prokurori i shtetit Shaqir Sedolli, i pandehuri L.Sh. dhe mbrojtësi sipas autorizimit av.Shpëtim Sadiku, më datë 20.01.2025 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 21.01.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: L.Sh. nga i ati J..., e ëma Sh..., e vajzërisë M..., data e lindjes... në fsh. ..., komuna e Lipjanit, ku edhe tani jeton, me numër personal të identifikimit ..., ka të kryer shkollën e mesme, i vetëpunësuar në auto sallonin “V...” në Lipjan magjistralja Prishtinë - Ferizaj, i martuar, prind i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa gjykuar.

Në bazë të nenit 362 paragrafi 1 pika 1.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPPK),

REFUZOHET AKUZA

SEPSE: Gjatë muajit shtator 2021, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten, e ka vënë në lajthim të dëmtuarin B.V., ashtu që automjetin e llojit Audi Q2, ngjyre e hiri, me targa të regjistrimit 02-516-EI, numri i shasisë WAZZZGA8KA005215, ia shet të dëmtuarin në auto sallonin e vetë, duke i thënë se automjeti është në rregull me letra dhe dokument përcjellës, andaj i dëmtuari këtë automjet e blen në shumën prej 20.800 euro, ndërsa më vonë përmes INTERPOL-it verifikohet se në Francë automjeti është lajmëruar si i vjedhur, andaj për këto arsyeje i njëjti sekuestrohet nga i dëmtuari dhe në këtë mënyrë i shkaktohet dëm material.

- Me këtë ka kryer veprën penale Mashtrimi nga neni 323 paragrafi 1 të KPRK-së

Shpenzimet e procedurës gjyqësore bien në barrë të kësaj gjykate.

Pala e dëmtuar B.V. ka hequr dorë nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP.II.nr. 362/21 e datës 26.05.2021, kundër pandehurit L.Sh. nga fshati ..., komuna e Lipjanit, për shkak të veprës penale *Mashtrimi* nga neni 323 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 22.02.2024, në të cilën seancë kanë prezantuar prokurori i shtetit Arjan Xhema, i pandehuri L.Sh. dhe mbrojtësi sipas autorizimit av.Shpëtim Sadiku.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i pandehuri ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë. Gjyqtari i vetëm gjykues e ka njoftuar të pandehurin dhe mbrojtësin e tij se në afat prej 30 ditësh ata mund të paraqesin, kundërshtimet e tyre për provat e cekura në aktakuzë, si dhe kërkesë për hedhjen e aktakuzës. I pandehuri L.Sh. me anë të mbrojtësit sipas autorizimit av.Shpëtim Sadiku me datë 19.03.2024 pranë kësaj gjykate ka parashtruar kërkesë për hedhje të aktakuzës, të cilin kërkesë gjykata konform dispozitave të KPPK-se i'a ka dërguar Prokurorisë Themelore në Mitrovicë për përgjigje, e që nga të njëjtit me datë 03.04.2024 kemi pranuar përgjigje në kërkesën e parashtruar nga i pandehuri përmes mbrojtësit të tij.

Gjykata me datë 02.05.2024 ka nxjerrë aktvendim me të cilin kërkesën për hedhje të aktakuzës të parashtruar nga i pandehuri me anë të avokatit mbrojtës e ka vlerësuar si të pa bazë, ky aktvendim pas ankesës së avokatit mbrojtës është vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin PN.nr.876/24 të datës 06.06.2024.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 09.12.2024 në të cilën seance i pandehuri është deklaruar i pa fajshëm pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit. Gjykata ka vazhduar me shqyrtimin gjyqësor ku palët janë deklaruar lidhur me fjalën hyrëse dhe janë administruar provat personale, përkatësisht është marr në pyetje i dëmtuari në cilësi të dëshmitarit.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 20.01.2025 në të cilën seance gjykata ka vazhduar me administrimin e provave personale ku në cilësinë e dëshmitarit është marr në pyetje dëshmitari E.I. dhe janë administruar edhe provat materiale lidhur me këtë çështje penale. Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se duke pasur parasysh faktin se gjatë këtij shqyrtimit gjyqësor dhe nga shkresat e lëndës nuk është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprën penale Mashtrimi nga neni 323 par.1 të KPRK-së, i njëjti është tërhequr nga aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.362/21 e datës 26.05.2021.

Gjykata duke u bazuar në nenin 362 par.1 nën par.1.1 të KPPK-së ku është përcaktuar se “Gjykata merr aktgjykim me të cilin akuza refuzohet kur prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza nga hapja deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor” ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi pasi që, prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit gjyqësor është tërhequr nga ndjekja penale lidhur me akuzën, e cila ka qenë objekt i shqyrtimit në këtë çështje penale dhe atë në fjalën përfundimtare të shqyrtimit gjyqësor.

Vendimin lidhur me shpenzimet procedurale gjykata e ka marr konform dispozitave të nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Vendimin lidhur me kompensimin e dëmit lidhur me palën e dëmtuar gjykata e ka marr konform dispozitave të nenit 460 par.1 të KPPK-së, ku është përcaktuar se “Personat e autorizuar mund të tërhiqen nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike në procedurë penale deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor dhe atë ta realizojnë në kontest civil. Kur propozimi tërhiqet, i njëjti propozim nuk mund të paraqitet përsëri, përveç nëse me këtë Kod është paraparë ndryshe.”, kjo pasi që në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 09.12.2024, i dëmtuari B.V. ka deklaruar se i pandehuri i ka kompensuar demin material të shkaktuar dhe se heq dorë nga kërkesa pasurore juridike.

Andaj, gjykata duke u bazuar në të lartcekurat ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.226/2021, datë 21.01.2025

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.